



Prishtinë: 28.10.2011

Kodi i ZRRE-së: V_381_2011

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_674_10_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_674_10_11**;

Në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2011 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET pjesërisht ankesa e konsumatorit Arben Kransiqi "Mini Max" (shifra e konsumatorit në KEK: DPR – 90034109), nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në këtë vendim.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 22.11.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK-ut – Departamentit për Konsumator të datës 27.10.2010, lidhur me kontestimin e tij ndaj ngarkesës për shfrytëzim të paautorizuar.

- Me datë 23.08.2006 KEK-u i ka lëshuar konsumatorit Pëlqimin Elektronenergjetik për objektin "Mini Max" në lagjen Arbëria me fuqi instaluese prej 60 kVA.
Provë: Pëlqimi elektronenergjetik nr. 2425 i datës 23.08.2006
- Me datë 18.06.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit në shifrën DPR – 90034109 dhe kanë konstatuar se energjia elektrike në këtë pikë matëse bëhet me metodë gjysëmnderekte me njehsor 5A dhe me reduktor të rrymës 100/5 ku numri i njehsorit 30662159 dhe gjendja e njehsorit është I = 1499.89 dhe II-3074.05. Energjia elektrike deri me datën 01.06.2007 duhet të faturohet me konstant C=30 ndërsa gjendja në numëror të njehsorit është në procesverbal të po kësaj date. Ndërsa llogaritja e energjisë elektrike prej gjendjes së përshkruar e tutje duhet të ndodh me C=20 sepse konsumatori ka bërë ndërrim të TMRR prej 150/5 në 100/5 Njehsori i vjetër i demontuar është i djegur aq shumë ashtu që nuk mund të shënohet karakteristikat dhe gjendja e njehsorit.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 0012180 i datës 18.06.2007
- Me datë 18.05.2007 Divizioni i Rrjetit në KEK në bazë të kompetencave të veta ka marrë vendim mbi formimin e komisionit për të analizuar të gjitha aspektet teknike të ndërtimit së TS pasi është paraqitur nevoja lidhur me pranimin intern të TS 10 920)/0.4 kV të konsumatorit Arben Krasniqi (Mini Max).
Provë: Vendimi i KEK-ut Divizioni i Rrjetit mbi formimin e komisionit nr. 2651 të datës 18.05.2007
- Me datë 30.05.2007 Divizioni i Rrjetit ka përpiluar procesverbalin nr. 2370 të datës 30.05.2007 ku komisioni i KEK-ut ka konstatuar se objekti është i kyçur në TS "Findanishte" në lagjen Arbëri me anë të linjës ajrore me shtylla të qimentës H=10m dhe kabull bistek. Matja e energjisë elektrike është gjysëmnderekte me njehsor 5A nr. 30662159 të lidhur nëpërmjet TMRR 150/5 A/A. Konsumatori pas vërejtjes që i është dhënë nga komisioni për TMRR e ka ndërrimin e tyre në 100/5 A/A sipas PEE.



Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 2370 i datës 30.05.2007

- Me datë 30.05.2007 Divizioni i Rrjetit në KEK ka përpiluar një shkresë për pranimin – bllombimin e grupit matës.
Provë: Shkresa për pranimin – bllombimin e grupit matës nr. 2879 të datës 30.05.2007
- Me datë 21.06.2007 punëtorët e KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse dhe kanë përpiluar procesverbalin – protokollin mbi montimin dhe demontimin apo ndërrimin e grupit matës. Në procesverbal punëtorët e KEK-ut kanë theksuar se njehsori i vjetër është i djegur ndërsa kanë montuar dhe vulosur njehsorin nr. 30662159 me numër të vulës 20071937 e me gjendje I = 01348.53 kWh dhe II = 2692.52 kWh, me konstante C= 30 dhe me TMRR.
Provë: Procesverbali – protokollin mbi montimin dhe demontimin - ndërrimin e grupit matës nr. 1722 të datës 21.06.2007
- Me datë 17.03.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar të dhënat e pikës matëse përfshi edhe TMRR e të cilët janë 100/5 A. Ekipi ka konstatuar se njehsori elektrik bënë regjistrimin e energjisë elektrike në mënyrë të rregullt si dhe është bërë shqyrtimi i përçuesve dhe vulosja e tyre.
Provë: Raporti mbi kontrollimin e grupit matës nr. 1369 i datës 17.03.2009
- Me datë 08.12.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër DPR – 90034109, dhe kanë konstatuar se konsumatori posedon njehsor gjysëmindirekt 5A, konsumatori nuk është i lidhur në rrjetin elektrik por furnizohet me energji nga gjeneratori.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 093137 i datës 08.12.2009
- Me datë 02.02.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër DPR – 90034109 dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik nuk ka bllombë distributive, transformatorët matës rrymor gjatë matjes kanë treguar këto vlera: L1 - Primari = 233.3 A, Sekondari = 2.93 A; L2 - Primari = 195.2A, Sekondari = 2.51 A; L3 - Primari = 180.2 A, Sekondari = 2.19 A; K=79.6. TMRR nuk janë të pllombuar dhe se bazuar në faturën nr. 8045262 konsumatroi faturohet me konstante C=20.
- Me datë 05.02.2010 konsumatori me shifër DPR – 90034109 ka parashtruar kërkesë për ndërrim njehsori.
Provë: Aplikacioni për ndërrim njehsori i datës 05.02.2010
- Me datë 05.02.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë përpiluar procesverbalin – protokollin mbi montimin – demontimin – ndërrimin e grupit matës, ku kanë demontuar njehsorin nr. 30662159 dhe kanë montuar njehsorin nr. 70172309.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 000896 i datës 05.02.2010
- Me datë 05.02.2010 KEK-u i ka lëshuar konsumatorit Arben Krasniqit “Mini Max” Pëlqimin elektronenergjetik të përkohshëm me fuqi instaluese prej 400 kVA, ku matja e energjisë elektrike të bëhet me njehsor multifunksional (aktive, reaktive dhe max) 3x220/380 V, 5A dhe i lidhur nëpërmes TMRR 400/5 A/A.
Provë: Pëlqimi elektronenergjetik i përkohshëm nr. 474 i datë 05.02.2010
- Me datë 19.02.2010 komisioni i KEK-ut i ka lëshuar një vendim konsumatorit me shifër DPR – 90034109 duke e ngarkuar konsumatorin me rikthim të humbjeve dhe se kjo faturë të llogaritet prej 08.12.2009 deri më 05.02.2010.
Provë: Vendimi i KEK-ut nr. 671 i datës 19.02.2010



- Me datë 19.02.2010 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DPR10HP08270 në vlerë 6,136.91 €.
Provë: Fatura DPR10HP08270 e datës 19.02.2010
- Me datë 23.06.2010 komisioni i KEK-ut ka bërë një raport për shqyrtimin e faturimit të rikthimit të humbjeve për konsumatorin me shifër DPR – 90034109. Sipas komisionit është vendosur që konsumatorit t'i bëhet korigjimi i faturës duke u kthyer mbrapa 12 muaj nga data e konstatimit të ndërrimit të transformatorët matës rrymor.
Provë: Raporti i shqyrtimit të faturimit për rikthimin e humbjeve për konsumatorin me shifër DPR – 90034109 nr. 154 të datës 23.06.2010

DMK, duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ KEK-u me datë 23.08.2006 i ka lëshuar konsumatorit Pëlqimin Elektroenergjetik objektit "Mini Max" në lagjen Arbëria me fuqi instaluese prej 60 kVA në të cilën po ashtu përcaktohen kushtet teknike të kycjes në rrjetin elektrik si dhe ka bërë edhe pranimin e TMRR-të e të cilat duhet të jenë 100/5 A/A.
Provë: Pëlqimi elektroenergjetik nr. 2425 të datës 23.08.2006
- ✓ Divizioni i Rrjetit në KEK me datë 17.05.2007 në bazë të kompetencave të veta ka lëshuar vendim mbi formimin e komisionit për të analizuar të gjitha aspektet teknike të ndërtimit të trafostacionit - TS pasi është paraqitur nevoja lidhur me pranimin intern të TS 10 (20)/0.4 kV të konsumatorit Arben Krasniqi (Mini Max). Komisioni i formuar i KEK-ut me urdhëresë të Drejtorit Ekzekutiv të Divizionit të Rrjetit me datë 30.05.2007 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se matja e energjisë elektrike në këtë pikë matëse bëhet me metodë gjysmë indirekte me njehsor 5A 30662159 të lidhur nëpërmjet TMRR 150/5. Konsumatori pas vërejtjes së bërë nga komisioni për TMRR, ka bërë ndërrimin e tyre në 100/5 A/A sipas Pëlqimit elektroenergjetik - PEE.
Provë: Vendimi i KEK-ut Divizioni i Rrjetit mbi formimin e komisionit nr. 2651 të datës 17.05.2007
- ✓ Punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 18.06.2007 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit të shifrës DPR – 90034109 dhe kanë konstatuar se matja e energjisë elektrike në këtë pikë matëse bëhet me metodë gjysmë indirekte me njehsor 5A dhe me reduktor të rrymës 100/5, ku numri i njehsorit 30662159 dhe gjendja e njehsorit është I = 1499.89 dhe II-3074.05. Energjia elektrike deri me datën 01.06.2007 duhet të faturohet me konstant C=30 ndërsa gjendja në numëror të njehsorit është në procesverbal të po kësaj date. Ndërsa llogaritja e energjisë elektrike prej gjendjes së përshkruar e tutje duhet të ndodh me C=20 sepse konsumatori ka bërë ndërrim të TMRR prej 150/5 në 100/5 Njehsori i vjetër i demontuar është i djegur aq shumë ashtu që nuk mund të shënohet karakteristikat dhe gjendja e njehsorit.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 1098 i datës 18.06.2007
- ✓ Me datë 30.05.2007 Divizioni i Rrjetit i KEK-ut ka përpiluar një shkresë për pranimin – vulosjen (bllombimin) e grupit matës.
Provë: Shkresa për pranimin – Vulosjen e grupit matës nr. 2879 të datës 30.05.2007
- ✓ Punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 21.06.2007 kanë inspektuar pikën matëse dhe kanë përpiluar procesverbalin – protokollin mbi montimin dhe demontimin apo ndërrimin e grupit matës. Në këtë procesverbal punëtorët e KEK-ut kanë theksuar se njehsori i vjetër është i djegur ndërsa kanë montuar dhe vulosur njehsorin nr. 30662159 me numër të vulës 20071937 e me gjendje I = 01348.53 kWh dhe II = 2692.52 kWh, me konstante C= 30 dhe me TMRR.



Provë: Procesverbali – protokollin mbi montimin dhe demontimin - ndërrimin e grupit matës nr. 1722 të datës 21.06.2007

- ✓ Me datë 17.03.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar të dhënat e pikës matëse përfshi edhe TMRR e të cilët janë 100/5 A. Ekipi ka konstatuar se njehsori elektrik nr. 30662159 bënë regjistrimin e energjisë elektrike në mënyrë të rregullt si dhe është bërë shqyrtimi i përçuesve dhe vulosja e tyre (1. 10092275, 2. 10092410 dhe 3. 10092477).

Provë: Raporti mbi kontrollimin e grupit matës nr. 1369 datë 17.03.2009

- ✓ Punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 08.12.2009 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër DPR – 90034109 dhe kanë konstatuar se konsumatori posedon njehsor gjysmë indirekt 5A, konsumatori nuk është i lidhur në rrjetin elektrik por furnizohet me energji nga gjeneratori si dhe mungon vula distributive e KEK-ut dhe se konsumatori mbetet i shkyçur.

Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 093137 i datës 08.12.2009

- ✓ Bazuar në analizën e procesverbalit të bërë nga ekipi inspektues të datës 08.12.2009 konstatohet se ekipi i KEK-ut nuk ka bërë kontrollën e grupit matës përfshirë TMRR duke anashkaluar inspektimin e tërësishëm ashtu siç parashihet me rregullat dhe procedurat në fuqi, por ë kanë konstatuar se mungon vula distributive e KEK-ut.

- ✓ Konsumatori ka bërë shkelje të nenit 12 të Regullës mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë duke mos bërë kërkesë tek ndërrmarja e energjisë për shkyçje.

- ✓ Konsumatori ka bërë shkelje të nenit 3 të Regullës mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë duke dëmtuar vulën distributive të KEK-ut.

- ✓ Konsumatori ka ofruar kërkesën për rritje të fuqisë bërë në KEK me datë 09.12.2009 dhe se kjo kërkesë është bërë pas inspektimit të pikës matëse nga ekipi i KEK-ut me datë 08.12.2009, por që bazuar në procesverbalin nr. 093137 konsumatori nuk është udhëzuar që të bëjë kërkesë për rritje të fuqisë.

Provë: Fletëdorëzimi i ankesës (kërkesës)

- ✓ Sipas rrjedhës të energjisë aktive vërehet se mesatarja e shpenzimit të energjisë prej periudhës 07/2007 e deri te periudha e ndërrimit të njehsorit elektrik 02/2010 kur konsumatori është faturuar me konstante C=20 ka qenë 15802 kWh/muaj, ndërsa mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike pas ndërrimit të njehsorit prej periudhës 02/2010 – 08/2011 kur konsuatmroi faturohet me konstante C=80 ka qenë 44950 kWh/muaj.

Provë: Rrjedha e energjisë aktive

- ✓ Punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 02.02.2010 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër DPR – 90034109 dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik nuk ka vulë (bllombë) distributive, transformatorët matës rrymor gjatë matjes kanë treguar këto vlera: L1 - Primari = 233.3 A, Sekondari = 2.93 A; L2 - Primari = 195.2A, Sekondari = 2.51 A; L3 - Primari = 180.2 A, Sekondari = 2.19 A; K=79.6. TMRR nuk janë të vulosura dhe se bazuar në faturën nr. 8045262 konsumatori faturohet me konstante C=20.

Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 363681 i datës 02.02.2010

- ✓ Punëtorët e KEK-ut-ut me rastin e inspektimit me datë 08.12.2009 dhe 02.02.2010 nuk kanë zbatuar procedurat e përcaktuara në Procedurën për Identifikimin dhe Parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, duke mos marrë masa të menjëhershme për të parandaluar shfrytëzimin e energjisë në formë të pa kontrolluar.



- ✓ Punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 05.02.2010 kanë përpiluar procesverbalin – protokollin mbi montimin – demontimin – ndërrimin e grupit matës, ku kanë demontuar njehsorin nr. 30662159 dhe kanë montuar njehsorin nr. 70172309 si dhe TMRR me konstantë 80.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 000896 i datës 05.02.2010
- ✓ KEK-u me datë 05.02.2010 i ka lëshuar konsumatorit Arben Krasniqit “Mini Max” Pëlqimin elektronenergjetik të përkohshëm me fuqi instaluese prej 400 kVA, ku matja e energjisë elektrike të bëhet me njehsor multi funksional (aktive, reaktive dhe max) 3x220/380 V, 5A dhe i lidhur nëpërmes TMRR 400/5 A/A.
Provë: Pëlqimi elektroenergjetik i përkohshëm nr. 474 i datë 05.02.2010
- ✓ Komisioni i KEK-ut me datë 19.02.2010 i ka lëshuar konsumatorit me shifër DPR – 90034109 një vendim duke e ngarkuar konsumatorin me rikthim të humbjeve dhe se kjo faturë të llogaritet prej 08.12.2009 deri më 05.02.2010.
Provë: Vendimi i KEK-ut nr. 671 i datës 19.02.2010
- ✓ KEK-u me datë 19.02.2010 e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DPR10HP08270 në vlerë 6,136.91 €.
Provë: Fatura DPR10HP08270 e datës 19.02.2010
- ✓ Komisioni i KEK-ut me datë 23.06.2010 ka bërë një raport për shqyrtimin e faturimit të rikthimit të humbjeve për konsumatorin me shifër DPR – 90034109. Sipas komisionit është vendosur që konsumatorit t’i bëhet korrigjimi i faturës në vlerë 33,769.81€, bazuar në konstanten C=80 duke u kthyer mbrapa 12 muaj nga data e konstatimit të ndërrimit të transformatorët matës rrymor. Me rastin e marrjes së vendimit për korrigjimin e faturës për periudhën 12 mujore (02/2009 deri më 01/2010) komisioni i KEK-ut nuk ka marruar parasysh raportin mbi kontrollimin e grupit matës nr. 1369 të datës 17.03.2009 me të cilin vërtetohet se njehsori elektrik si dhe TMRR-të e pikës matëse janë në rregull përkatësisht karakteristikat e TMRR-ve janë të njëjtat siç janë të parapara në PEE.
Provë: Raporti i shqyrtimit të faturimit për rikthimin e humbjeve për konsumatorin me shifër DPR – 90034109 nr. 154 të datës 23.06.2010
- ✓ Bazuar në analizën e përgjithshme të rrjedhës së energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka ndryshim në shpenzimin e energjisë. Për periudhën 07/2007 deri më 02/2010 shpenzimi mesatar mujor ka qenë **727 kWh/muaj** ndërsa nga periudha 02/2010 deri më 08/2011 është **628 kWh/muaj**, e që shprehur në përqindje ka një rënie prej **29%** të shpenzimit të energjisë elektrike.
Provë: Rrjedha e energjisë elektrike
- ✓ DMK bazuar në listat e leximit të ofruara nga KEK sha konstaton se lexuesi i KEK-ut në asnjë rast nuk ka evidentuar se njehsori elektrik nr. 30662159 është i dëmtuar apo që mungon vula distributive e KEK-ut, por që në periudhat 10/2009 dhe 11/2009 nuk ka shpenzim të regjistruar të energjisë përkatësisht është përshkruar gjendja e njëjtë me periudhën 09/2009.
Provë: Listat e leximit të KEK-ut
- ✓ Konsumatori ka ofruar Aktvendimin e lëshuar nga Komuna e Prishtinës(Drejtoria e Urbanizmit,Kadastrës dhe Mbrojtje të Mjedisit) sipas së cilit bazuar në kërkesën e Miftar Krasniqi dhe Habib Krasniqi për dhënien e lejes ndërtimore nr. 05-351-25277 të datës 25.09.2008 ka vendosur ti lejon Miftar Krasniqi dhe Habib Krasniqi ndërtimi i objektit afarist në bllokun urbanistik E4 të tërësisë urbane “E” me atazhitet B+P+4 në kuadër të Planit Rregullues “Arberia 3”, në pjesën e ngastrës kadastrave nr. 2967/1 (të evidentuar në fletën poseduese nr. 4179 KK Prishtinë) dhe ngastrat kadastrave nr. 2967/8, nr. 2967/17(të evidentuara në fletën poseduese nr. 11169 KK Prishtinë.



Provë: Aktvendimi i lëshuar nga Komuna e Prishtinës(Drejtoria e Urbanizmit,Kadastrës dhe Mbrojtje të Mjedisit)

- ✓ Konsumatori N.P. Mini Max ka ofruar kontratën e lidhur me datë 04.05.2009 mes tij dhe kompanisë ndërtuese “Nëntë vëllezërit”, për ndërtimin e objektit me sipërfaqe prej 4000 m² si dhe janë pajtuar që objekti të përfundoj në muajin gusht 2009. Për punën e kontraktuar në mes kompanisë Mini Max dhe kompanisë Nëntë Vëllezërit konsumatori ka ofruar pagesat e bëra përmes ProCredit Bank me datë 04.12.2009 në vlerë 7000€.

Provë: Kontrata dhe pagesa e bëra në Procredit Bank

- ✓ Konsumatori ka ofruar faturën numër 005131 datë 28.09.2009 për blerjen e dy gjeneratorëve, njeri me fuqi 100 KVA dhe tjetri me fuqi 150 KVA. Bazuar në faturën e blerjes konstatohet se vlera totale e kostos së gjeneratorëve është 18,997.07€, e që vërtetohet edhe me dy pagesat e bëra nga blerësi “Mini Max” përmes xhirollogarisë në ProCredit Bank 07.10.2009 dhe 06.11.2009 në kompaninë “Contanti Generators”-shpk.

Provë: Fatura e blerjes nr. 005131 datë 28.09.2009 si dhe pagesat në ProCredit Bank të datës 07.10.2009 dhe 06.11.2009

- ✓ Konsumatori ka ofruar faturën e blerjes së TMRR-ve me datë 15.12.2009 nga ndërmarrja tregtare private “EL-3”.

Provë: Fatura nr. 05085 datë 15.12.2009

DMK pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura ka rekomanduar Bordin e ZRRE-së që të **refuzojë pjesërisht** ankesën e konsumatorit dhe vjen në përfundim se:

1. KEK-u duhet të shkarkojë konsumatorin nga korrigjimi nr. 28538 të datës 27.08.2010 në vlerë prej 33,769.81 €.
2. KEK-u duhet të mbajë faturën e rikthimit DPR10HP08270 të datës 19.02.2010 në vlerë prej 6,136.91 €.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që të **refuzon pjesërisht** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Të shkarkojë konsumatorin nga korrigjimi nr. 28538 të datës 27.08.2010 në vlerë prej 33,769.81 €.
2. Të mbajë faturën e rikthimit DPR10HP08270 të datës 19.02.2010 në vlerë prej 6,136.91 €.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Enver Halimi, anëtar